

VENDIM
Nr. 757, datë 12.11.2014

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E KULTURËS, PËR TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS DHE BALETIT E ANSAMBLIN POPULLOR, TË OBJEKTEVE DHE TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 11 754.2 M², PJESË E PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM “SHA RIPARIM ARTILERIE”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, për Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblin Popullor, të objekteve nr. 16, 17, 18 e 21 dhe truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m², pjesë e pronës nr. 109, me emërtim “Sh.a. Riparim Artilerie”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për magazinimin dhe përpunimin e dekoreve të shfaqjeve.

2. Sipërfaqja e përgjithshme prej 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m², e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Kulturës, Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblit Popullor u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.


4. Vendimi nr. 634, datë 23.7.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblin Popullor, të objektit nr. 19, “Godina e sinoptikës së vjetër”, pjesë e pronës nr. 109, “Ish-Uzina e Artilerisë”, në Brar, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar me vendimin nr. 198, datë 16.3.2011, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Kulturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan vendosja e prones nr.109 SHA Riparim Artilerie Brar,TIRANE.
(Sip. dhe objektet qe kerkohen per kalim nga Ministria e Mbrojtjes ne administrim te Ministrise se k
koordinatave shtetere



Shpjeguese prona109

Sip e pergjithshme = 43169.2 m2

Kufiri i repartit

 Sip S3 = 11754.2 m2 (sip qe kerkohet per kalim ne administrim te Ministrise se Kultures "TKOBAP".)
Sip.e ndertimit = 4913.74m2(sip.e ndertimit e objekteve me nr. 16,17,18,21 (sip.e ndertimit qe kerkohet per kalim ne administrim te Ministrise se Kultures "TKOBAP").

 Sip S2 = 18179 m2 (sip.qe kerkohet per kalim ne administrim te Sip.e ndertimit =3761.07 m2(sip.e ndertimit e objekteve me nr.6,7,8,10,11,12,14,15 qe kerkohen per kalim ne administrim te DF

 Sip S1 = 13236.0 m2 sip.qe mbetet ne administrim te MM

Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.G.J.U-s
shkreses dhe skicës bashklidhur me nr.6357/3 dt.28-08-2014,të Sekretarit te Përgjijt

unuar Shtator 2014.

0

404 950

405 150

Shkalla 1:2500